



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 142 Prot.

Kamëz, më 06 . 10 .2020

V E N D I M

Nr. 122 Datë 06 . 10 .2020

PËR

**MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA TË AMBJENTEVE BRENDA
PALLATIT TË KULTURËS (ZONA E PARKIMIT) TË LLOJIT “NDËRTESE” ME
SIPËRFAQE 1026 m², NË PRONËSI TË BASHKISË KAMËZ**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **06.10.2020** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.112 Datë 02.10.2020**, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nën pikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2 shkronja “c”, nenit 54, shkronja “c” dhe nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; nenit 28, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 8744, date 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; Vendimin nr. 775, datë 05.09.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz”; Kreut II, të vendimit nr. 54 datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar; Udhëzimit nr.13 datë 26.04.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar; **Këshilli Bashkiak Kamëz:**

V E N D O S I :

1. Miratimin në parim të dhënies me qira të ambjenteve brenda Pallatit të Kulturës (zona e parkimit) të llojit “ndërtesë”, si e tërë ose e ndarë në njësi, me sipërfaqe totale 1026 (një mijë e njëzet e gjashtë) m², me zonë kadastrale nr. 2066, me nr. pasurie 92/30 në pronësi të Bashkisë Kamëz.